

Rasti i vdekjes

Kur një person prej familjes suaj vdes, ju duhet ta raportoni rastin autoritetit zyrtar. Nëse dëshironi, autoriteti thirr një shërbim funerali. Shërbimi funeral e transporton kufomën deri tek varrezat ose jashtë shtetit.

Raportimi i një vdekjeje

Kur një njeri prej familjes suaj vdes, një mjek ose mjeke duhet të plotësojë certifikatën e vdekjes. Pastaj ju duhet t'ia lajmëroni vdekjen zyrës së gjendjes civile të kantonit Basel-Stadt.

Personi vdes në spital, në strehimore pleqsh ose në stehimorën e përkujdesjes:

- Drejtoria e spitalit ose të strehimores duhet t'ia lajmërojë vdekjen zyrës së gjendjes civile.

Personi vdes në një vend tjetër:

- Ju si të afërmit duhet t'ia lajmëroni vdekjen zyrës së gjendjes civile të kantonit Basel-Stadt.

Çdo njeri, që jeton në kantonin Basel-Stadt, merr një varrim me arkivol ose me urnë falas.

Riatdhesimi i eshtrave

Ndoshta një person prej familjes suaj ka vdekur në kantonin Basel-Stadt. Por ju dëshironi, që personi të varroset jashtë shtetit. Për këtë, një kompani e licencuar funerali duhet të përpilojë një protokoll: Protokoll quhet "Protokoll për vendosjen në arkivol dhe për vulosjen". Origjinalin e protokollit duhet të parashtroji tek zyra e varrimeve të kantonit Basel-Stadt. Në vijim zyra e varrimeve lëshon një pasaportë kufome. Kompania e funeralit lejohet vetëm me këto dokumente ta transportojë kufomën drejt varrezave jashtë shtetit. Ju si të afërmit duhet t'i paguani shpenzimet për këtë shërbim.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-baselstadt.ch/sq/shendetit/todesfall